



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MBLEDHJA E PËRGJITHSHME E PROKURORËVE

RREGULLORE

Nr. 3152/5, Datë 11.12.2018

**PËR PROCESIN E VOTIMIT PËR ZGJEDHJEN E ANËTARËVE PROKURORË  
TË KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË**

Në mbështetje të nenit 149, pikat 2 dhe 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 279, pika 6 dhe nenit 111 e vijues të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, dhe me propozim të Prokurorit të Përgjithshëm

MBLEDHJA E PËRGJITHSHME E PROKURORËVE

MIRATON KËTO RREGULLA:

KREU I  
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

**Objekti i rregullores**

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave për zgjedhjen e anëtarëve të komisionit të votimit dhe për procesin e votimit të kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

## Neni 2

### **Pjesëmarrja në Mbledhjen e Përgjithshme të Prokurorëve**

1. Në Mbledhjen e Përgjithshme të Prokurorëve marrin pjesë të gjithë magjistratët e emëruar si prokurorë dhe që kryejnë funksionet e prokurorit, të gjithë prokurorët që kanë statusin e magjistratit dhe që shërbejnë për një kohë të caktuar në strukturat e tjera shtetërore, si dhe të gjithë prokurorët që janë me leje sipas ligjit, me kusht që, në ditën e votimit nuk kanë mbushur moshën e pensionit. Prokurorët e pezulluar gjatë procesit të rivlerësimit, të pezulluar nga Prokurori i Përgjithshëm apo me vendim gjyqësor, nuk mund të marrin pjesë dhe as të votojnë në këtë mbledhje.

2. Administrata e Prokurorisë së Përgjithshme harton paraprakisht listën emërore të prokurorëve.

## Neni 3

### **Drejtimi i Mbledhjes së Përgjithshme të Prokurorëve**

Prokurori i Përgjithshëm drejton punimet e Mbledhjes së Përgjithshme të Prokurorëve.

## Neni 4

### **Kuorumi**

1. Para fillimit të punimeve të Mbledhjes së Përgjithshme, administrata e Prokurorisë së Përgjithshme harton listën emërore të prokurorëve të pranishëm duke verifikuar pjesëmarrjen nëpërmjet dokumentit të identifikimit dhe nënshkrimit nga çdo prokuror. Lista emërore i dorëzohet Prokurorit të Përgjithshëm dhe i vihet në dispozicion Komisionit të Votimit, menjëherë pas zgjedhjes së tij.

2. Prokurori i Përgjithshëm, pasi verifikon dhe sigurohet për ekzistencën e kuorumi të nevojshëm, i përcaktuar nga neni 112/2 i ligjit nr.115/2016, vijon me zhvillimin e punimeve të Mbledhjes të Përgjithshme të Prokurorëve (kuorumi konstitutiv përbëhet kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e numrit të përgjithshëm të prokurorëve).

## Neni 5

### **Sigurimi i transparencës**

1. Mbledhja e Përgjithshme e Prokurorëve, në të gjitha fazat e saj, është e hapur për mediat dhe të gjithë vëzhguesit që shprehin interes për ta ndjekur.

2. Kandidatët për anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë mund të caktojnë vëzhgues që autorizohen paraprakisht nga Prokurori i Përgjithshëm për të ndjekur procesin.

3. Administrata e Prokurorisë së Përgjithshme pajis me fletë - hyrje vëzhguesit, pasi verifikon pajisjen me autorizimin paraprak nga Prokurori i Përgjithshëm të të interesuarve.

4. Ministri i Drejtësisë ose personi i autorizuar prej tij dhe 2 anëtarë të komisionit të përhershëm përgjegjës për çështjet ligjore në Kuvend, nuk kanë nevojë për autorizim.

## KREU II PREZANTIMI I KANDIDATËVE DHE KOMISIONIT TË VOTIMIT

Neni 6

### **Prezantimi i listës së kandidatëve**

Prokurori i Përgjithshëm prezanton listën e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, sipas shkallëve të prokurorisë si dhe numrin e vendeve vakante për çdo shkallë.

Neni 7

### **Komisioni i votimit**

1. Për administrimin e procesit të votimit, krijohet Komisioni i Votimit me përbërje 3 prokurorë të Prokurorisë së Përgjithshme të zgjedhur me short në përputhje me nenin 114/4 i ligjit 115/2016. Gjatë zhvillimit të shortit, ftohen të marrin pjesë si vëzhgues, përfaqësues të institucioneve shtetërore dhe organizmave ndërkombëtare që asistojnë sistemin e drejtësisë. Procedura e zhvillimit të shortit pasqyrohet në procesverbal i cili nënshkruhet nga Prokurori i Përgjithshëm dhe sekretari i ngarkuar për hartimin e tij.

2. Nën përgjegjësinë e Prokurorit të Përgjithshëm, përpara datës së thirrjes së Mbledhjes së Përgjithshme, organizohet shorti për zgjedhjen e tre anëtarëve të Komisionit të Votimit, sipas procedurës vijuese:

- a) shorti hidhet ndërmjet prokurorëve të Prokurorisë së Përgjithshme që nuk kandidojnë për anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë;
- b) në një mbajtëse transparente futen aq gogla të njëjta sa është edhe numri i kandidatëve, pjesëmarrës në short. Në secilën prej goglave futet një shirit letre ku shkruhet respektivisht emri i një prokurori;
- c) ftohet një nga të pranishmit në mbledhje që nuk është kandidat pjesëmarrës në short apo kandidat për anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, të tërheqë tre gogla të cilat pasi i hap, i lexon me zë të lartë dhe ua tregon të gjithë pjesëmarrësve;
- ç) procedura konsiderohet e mbyllur, pasi hapen me rradhë goglat e mbetura dhe u tregohen pjesëmarrësve në mbledhje, duke provuar rregullsinë e procesit;
- d) pas përfundimit të procedurës së hedhjes së shortit, Prokurori i Përgjithshëm shpall rezultatin e shortit duke deklaruar përbërjen e Komisionit të Votimit.

3. Komisioni i votimit zgjedh nga radhët e tij me short kryetarin, sipas rregullave të mëposhtme:

- a) në një mbajtëse transparente futen 3(tre) gogla të njëjta, (një për secilin prej anëtarëve të zgjedhur të Komisionit të Votimit). Në secilën prej goglave futet një shirit letre ku shkruhet respektivisht emri i një anëtari;
- b) ftohet një nga të pranishmit në mbledhje që nuk është kandidat pjesëmarrës në short apo anëtar i Komisionit të Votimit, të tërheqë një gogël të cilën pasi e hap, e lexon me zë të lartë dhe ua tregon të gjithë pjesëmarrësve;
- c) anëtari, emri i të cilit është përzgjedhur, caktohet kryetar i komisionit;
- ç) procedura konsiderohet e mbyllur, pasi hapen me rradhë goglat e mbetura dhe u tregohen pjesëmarrësve në mbledhje, duke provuar rregullsinë e procesit.

#### Neni 8

### **Prezantimi i Komisionit të Votimit**

Përpara zhvillimit të procedurës së votimit, Prokurori i Përgjithshëm prezanton anëtarët e Komisionit të Votimit dhe i fton ata që të afrohen në vendin ku do të zhvillohet votimi.

#### Neni 9

### **Prezantimi i platformës nga kandidatët**

1. Kandidatët për anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, kanë të drejtë të paraqesin platformat e tyre përpara Mbledhjes së Përgjithshme të Prokurorëve, përpara nisjes së procedurës së votimit.

2. Përpara fillimit të procedurës së votimit, Prokurori i Përgjithshëm fton çdo kandidat që është i pranishëm, për të prezantuar platformën. Prezantimi i kandidatëve bëhet në rend alfabetik për çdo shkallë prokurorie, duke filluar nga Prokuroria e Përgjithshme.

3. Çdo kandidat ka në dispozicion jo më shumë se 5 minuta kohë diskutimi.

## KREU III

### PROCESI I VOTIMIT

#### Neni 10

### **Veprimet paraprake nga Komisioni i Votimit**

1. Përpara fillimit të votimit, Komisioni i Votimit verifikon numrin e prokurorëve të pranishëm në listën emërore të hartuar sipas nenit 4/1 të kësaj rregulloreje (*Aneksi 1 bashkëlidhur*) që duhet të përmbajë për çdo prokuror këto rubrika: emrin, atësinë, mbiemrin, prokurorinë ku ushtron funksionet, numrin e dokumentit të identifikimit, vendin e nënshkrimit për pjesëmarrjen dhe vendin e nënshkrimit për votimin. Komisioni merr

vendim për përfshirjen në listën emërore të atyre prokurorëve që për arsye objektive, janë paraqitur pas fillimit të Mbledhjes por, deri në momentin e përfundimit të procesit të votimit.

2. Anëtarët e Komisionit të Votimit administrojnë modelin tip të fletës së votimit miratuar me urdhër të Prokurorit të Përgjithshëm dhe shumëfishojnë e nënshkruajnë paraprakisht një numër fletësh votimi të barabartë me numrin e prokurorëve që janë të pranishëm në mbledhje. Në rast të dëmtimit të një ose disa fletëve të votimit, komisioni nënshkruan një numër fletësh votimi të barabartë me fletët e dëmtuara dhe shkatërron, në praninë e pjesëmarrësve, fletët e dëmtuara. Për pajisjen me fletë votimi të prokurorëve të paraqitur pas fillimit të mbledhjes, komisioni nënshkruan një numër fletësh votimi të barabartë me numrin e prokurorëve të paraqitur me vonesë.

3. Kutitë e votimit vendosen në ambiente që lejojnë monitorimin e tyre nga pjesëmarrësit. Administrata e Prokurorisë së Përgjithshme siguron mbajtjen rezervë të kutive të votimit në rast dëmtimi apo nevojë tjetër.

4. Kryetari i Komisionit të Votimit u shpjegon shkurtimisht prokurorëve votues, duke përdorur edhe mjetet e teknologjisë së informacionit, kur është e mundur, rregullat për mënyrën e votimit, referuar shkallëve të prokurorisë, numrit të fletëve të votimit për çdo shkallë prokurorie, numrit të kandidatëve për çdo fletë votimi dhe rastet e pavlefshmërisë së fletëve të votimit.

#### Neni 11

### **Procedura e votimit**

1. Gjatë mbledhjes dhe veçanërisht gjatë procesit të votimit, prokurorët respektojnë rregullat e etikës zyrtare, duke garantuar zhvillimin e qetë të procesit. Në rast të shkeljes së këtyre normave, Komisioni i Votimit ka të drejtë të vendosë pezullimin e votimit, deri në vendosjen e rregullit.

2. Votimi është i fshehtë dhe individual. Çdo prokuror i regjistruar në listë, ka të drejtën e një vote. Nuk lejohet votimi me përfaqësim.

3. Çdo prokuror i pajisur me dokumentin e identifikimit, pasi tërheq fletën e votimit, nënshkruan në listën e prokurorëve që administrohet nga Komisioni i Votimit.

4. Votimi bëhet në ambiente të veçanta të vendosura në mënyrë të tillë që të sigurojnë fshehtësinë e procesit.

5. Anëtarët e Komisionit të Votimit votojnë në fund të procesit të votimit.

#### Neni 12

### **Mënyra e votimit dhe rastet e pavlefshmërisë së votës**

1. Prokurorët votues duhet të ndjekin rregullat e votimit si vijon:

- a) votohet vetëm në fletën/setet e fletëve, të vëna në dispozicion nga Komisioni i Votimit. Nëse seti nuk përmban numrin e saktë të fletëve të dhëna nga Komisioni, të gjitha fletët e tjera dhe fletët e gjetura të veçuara, do të jenë të pavlefshme dhe nuk do të numërohen si vota;
- b) fletët e votimit hidhen në kutitë e votimit të cilat janë të veçanta për secilën shkallë prokurorie që kandidohet;
- c) votohet duke vendosur në kutinë përbri emrit të kandidatit, një nga shenjat +; x; √. Në fletën e votimit të mos bëhen shënime të tjera përveç shenjës së votimit, pasi çdo shënim tjetër e bën votën të pavlefshme;
- ç) ka vetëm një votë për fletë votimi. Asnjë kandidat nuk mund të votohet më shumë se një herë nga i njëjti prokuror, pasi kjo votë do të jetë e pavlefshme dhe nuk do të numërohet.

2. Vota të pavlefshme janë fletët e votimit kur:

- a) fleta e votimit nuk ka të njëjtat elemente të miratuara nga komisioni i votimit;
- b) në fletën e votimit janë bërë shënime në favor ose në disfavor të kandidatëve;
- c) është votuar për më shumë se një nga kandidatët, në një fletë votimi;
- ç) nuk është votuar për asnjë nga kandidatët;
- d) nuk është e qartë se për cilin kandidat është votuar;
- dh) është votuar për një person që nuk është regjistruar si kandidat në fletën e votimit.

3. Pavlefshmëria e konstatuar në një fletë votimi, e bën të pavlefshme votën për atë fletë votimi, por nuk shtrihet në fletët e tjera të votimit të bashkëlidhura me të.

Neni 13

**Numërimi i votave**

1. Pas votimit nga të gjithë prokurorët e pranishëm, anëtarët e Komisionit të Votimit, njoftojnë për përfundimin e procesit të votimit.

2. Nën përgjegjësinë e Prokurorit të Përgjithshëm dhe në prani të të gjithë prokurorëve që marrin pjesë në mbledhje, anëtarët e komisionit të votimit hapin kutitë e votimit.

3. Komisioni i Votimit fillimisht përcakton numrin e fletëve për çdo kuti dhe numrin e përgjithshëm të fletëve të votimit. Komisioni numëron me zë të lartë çdo votë.

4. Votat që gjykohen të pavlefshme, në përputhje me nenin 115/2 të ligjit 115/2016, rivlerësohen në fund të procesit të numërimit. Në rast mosmarrëveshjeje mes anëtarëve të komisionit të votimit për vlefshmërinë e votave, vendimet merren në fund të procesit të rivlerësimit me shumicën e votave. Votat që gjykohen të vlefshme në fund të procesit të rivlerësimit u shtohen kandidatëve përkatës.

Neni 14

**Hartimi i procesverbalit**

1. Në përfundim të procesit të votimit dhe të numërimit të votave, anëtarët e komisionit të votimit hartojnë dhe miratojnë një procesverbal (*aneksi 2 bashkëlidhur*), i cili tregon numrin e pjesëmarrësve, numrin total të votave të hedhura, numrin e votave të hedhura për secilën kategori kandidatësh, numrin e votave të pavlefshme, në qoftë se ka të tilla, numrin e votave për çdo kandidat dhe emrat e kandidatëve fitues.

2. Rastet e mosmarrëveshjeve midis anëtarëve të komisionit të votimit për vlefshmërinë e votave dhe mënyra e zgjidhjes së tyre shënohen në procesverbal.

3. Në procesverbal shënohet edhe numri i fletëve të votimit që janë zëvendësuar për shkak të dëmtimit.

#### Neni 15

### **Shpallja e rezultatit të votimit**

1. Komisioni i votimit, pas përfundimit të numërimit të votave, rendit kandidatët sipas votave që kanë marrë.

2. Në fund të procesit të votimit quhen të zgjedhur kandidatët që kanë marrë numrin më të madh të votave.

3. Për të garantuar përfaqësimin në Këshillin e Lartë të Prokurorisë të prokurorive të shkallës së parë jashtë Tiranës, në përputhje me nenin 105 të ligjit 115/2016, në rast se të tre kandidatët me më shumë vota janë zgjedhur nga prokuroria e shkallës së parë Tiranë (përfshi atë për Krime të Rënda), vetëm dy kandidatët me më shumë vota do të quhen të zgjedhur. Fituesi i tretë do të zgjidhet kandidati i një prokurorie të shkallës së parë, jashtë Tiranës që ka marrë numrin më të madh të votave. Po kështu, në rast se të dy kandidatët me më shumë vota janë zgjedhur nga prokuroria e apelit Tiranë (përfshi atë të apelit për Krime të Rënda), vetëm një kandidat, ai me më shumë vota do të quhet i zgjedhur dhe fituesi i dytë do të zgjidhet kandidati i një prokurorie apeli jashtë Tiranës, që ka marrë numrin më të madh të votave.

4. Në qoftë se, pas procesit të votimit, kandidatët e prokurorive të Shkallës së Parë, jashtë Tiranës, nuk kanë marrë asnjë votë, atëherë do të zhvillohet një raund i dytë votimi, vetëm mes kandidatëve të prokurorive të Shkallës së Parë, jashtë Tiranës ku në përfundim, do të quhet fitues kandidati që ka marrë numrin më të madh të votave.

#### Neni 16

### **Shorti për kandidatët me vota të barabarta**

Në qoftë se dy ose më shumë kandidatë kanë marrë të njëjtin numër votash, fituesi përcaktohet me short midis tyre, i cili hidhet nga Komisioni i Votimit sipas rregullave të mëposhtme:

- d) në një mbajtëse transparente futen aq gogla të njëjta, sa janë kandidatët me të njëjtin numër votash. Në secilën prej goglave futet një shirit letre ku shkruhet respektivisht emri i një kandidati;
- e) ftohet një nga të pranishmit në mbledhje që nuk është kandidat pjesëmarrës në short apo anëtar i Komisionit të Votimit, të tërheqë një gogël të cilën pasi e hap, e lexon me zë të lartë dhe ua tregon të gjithë pjesëmarrësve;
- f) kandidati, emri i të cilit është përzgjedhur, përcaktohet si fitues;
- ç) procedura konsiderohet e mbyllur, pasi hapen me radhë goglat e mbetura dhe u tregohen pjesëmarrësve në mbledhje, duke provuar rregullsinë e procesit.

#### Neni 17

### **Administrimi i dokumentacionit të Mbledhjes**

1. Procesverbali origjinal që tregon numrin e pjesëmarrësve në Mbledhjen e Përgjithshme, numrin e votave dhe rezultatin e numërimit të votave, i nënshkruar nga të gjithë anëtarët e komisionit të votimit, i dërgohet menjëherë Prokurorit të Përgjithshëm.

2. Vendimet me rezultatin e zgjedhjeve dhe shpalljen e fituesve, çdo vendim i ndërmjetëm dhe procesverbali nënshkruhen bashkërisht nga anëtarët e komisionit të votimit.

3. Vendimet njoftohen publikisht në fund të Mbledhjes së Përgjithshme.

4. Vendimet do të shpallen zyrtarisht në faqen zyrtare të Prokurorisë së Përgjithshme, jo më vonë se 24 orë nga mbyllja e Mbledhjes së Përgjithshme. Vendimi për shpalljen e fituesve dërgohet nga Prokurori i Përgjithshëm për t'u botuar në Fletoren Zyrtare, në përputhje me nenin 115/ 7 të ligjit 115/2016

5. Dokumentacioni i krijuar në zbatim të këtij procesi do të administrohet në zyrën e protokoll-arkivit të Prokurorisë së Përgjithshme.

## KREU IV DISPOZITA TË FUNDIT

#### Neni 18

### **Ndryshimet**

1. Ndryshimet në këtë Rregullore miratohen kur votojnë shumica e të gjithë anëtarëve të pranishëm të Mbledhjes së Përgjithshme të Prokurorëve.

2. Propozime për ndryshime në Rregullore mund të bëhen nga Prokurori i Përgjithshëm, ose me kërkesën e 1/10 të anëtarëve të Mbledhjes së Përgjithshme të Prokurorëve dhe ndryshimet miratohen kur votojnë shumica e të gjithë anëtarëve të pranishëm të Mbledhjes



së Përgjithshme të Prokurorëve.

#### Neni 19

#### **Thirrja e Mbledhjes së Përgjithshme nga anëtarët**

1. Kur Mbledhja e Përgjithshme e Prokurorëve është thirrur nga një e dhjeta e numrit të përgjithshëm të prokurorëve, sipas ligjit, ajo drejtohet nga njëri prej prokurorëve nismëtarë, i zgjedhur nga vetë prokurorët nismëtarë.

2. Detyrat e parashikuara në këtë rregullore për Prokurorin e Përgjithshëm, ushtrohen nga prokurori i zgjedhur për të drejtuar mbledhjen.

#### Neni 20

#### **Hyrja në fuqi**

1. Rregullorja konsiderohet e miratuar kur votohet nga shumica e të gjithë anëtarëve të pranishëm të Mbledhjes së Përgjithshme të Prokurorëve.

2. Kjo Rregullore hyn në fuqi menjëherë pas miratimit.

**LISTA E PJESEMARRËSVE DHE VOTUESVE  
NË MBLIEDHJEN E PËRGJITHSHME TË PROKURORËVE**

NR.	EMËR MBIEMËR	PROKURORIA	NR. DOKUMENTI IDENTIFIKIMI	NËNSHKRIMI PËR VERIFIKIMIN E PJESEMARRJES <i>(Emër mbiemër nënshkrim)</i>	NËNSHKRIMI PËR PROCESIN E VOTIMIT <i>(Emër mbiemër nënshkrim)</i>

**MBLEDHJA E PËRGJITHSHME E PROKURORËVE  
KOMISIONI I VOTIMIT**

*Aneksi 2*

Tiranë, më \_\_\_/\_\_\_/2018

**PROCESVERBAL**

**I PROCESIT TË VOTIMIT NGA MBLEDHJA E PËRGJITHSHME E  
PROKURORËVE PËR ZGJEDHJEN E ANËTARËVE PROKURORË TË  
KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË**

Sot, më \_\_\_/\_\_\_/2018, në \_\_\_\_\_, mbahet ky procesverbal për të dokumentuar votimin nga Mbledhja e Përgjithshme e prokurorëve për zgjedhjen e anëtarëve prokurorë për Këshillin e Lartë të Prokurorisë, në bazë të nenit 115, pika 3 të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

*Numri i pjesëmarrësve*

*Numri total i votave të hedhura*

*Numri i votave të hedhura për secilën kategori kandidatësh*

*Numri i votave të pavlefshme, në qoftë se ka të tilla,*

*Numri i votave për çdo kandidat*

*Emrat e kandidatëve fitues*

*Rastet e mosmarrëveshjeve midis anëtarëve të komisionit të votimit për vlefshmërinë e votave dhe mënyra e zgjidhjes së tyre.*

*Numri i fletëve të votimit që janë zëvendësuar për shkak të dëmtimit.*

**KOMISIONI I VOTIMIT**

**ANËTAR**  
**(Emër mbiemër)**

**ANËTAR**  
**(Emër mbiemër)**

**ANËTAR**  
**(Emër mbiemër)**